

UDHËZIM
Nr. 211, datë 3.4.2017

PËR PËRBËRJEN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONEVE TË VLERËSIMIT
TË GRADAVE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 të nenit 24 të ligjit nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”,

UDHËZOJ:

1. Ngritjen e komisioneve të vlerësimit të gradave, për strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në nivel qendror për punonjësit e nivelit të mesëm, të lartë dhe madhor dhe në nivel vendor për punonjësit e nivelit bazë.

2. Komisioni i Vlerësimit të Gradave në nivel qendror përbëhet nga:

- a) Drejtor/shef sektori në shërbimin e kryetar;
MZSH-së në ministrinë përgjegjëse,
- b) Specialist në sektorin e menaxhimit të anëtar;
burimeve njerëzore, në ministrinë përgjegjëse,
- c) Specialist në Drejtorinë e Shërbimit të anëtar.
MZSH-së në ministrinë përgjegjëse,

3. Komisioni i Vlerësimit të Gradave në nivel vendor përbëhet nga:

- a) Drejtor/shef sektori i shërbimit të kryetar;
MZSH-së në bashki,
- b) Specialist i burimeve njerëzore në bashki, anëtar;
- c) Specialist në Drejtorinë Shërbimit të anëtar.
MZSH-së në ministrinë përgjegjëse,

4. Komisionet e vlerësimit të gradave funksionojnë si organ kolegjal vlerësues dhe propozues në zbatim të dispozitave të ligjit nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.

5. Komisionet e vlerësimit të gradave trajtojnë çdo kërkesë të punonjësve të shërbimit të MZSH-së, për vlerësimin e gradave në përputhje me parimet dhe afatet e ligjit nr.44/2015 “Kodit i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”.

6. Komisionet e vlerësimit të gradave, në përfundim të shqyrtimit të kërkesës, hartojnë aktin e vlerësimit, në përputhje me kriteret e ecurisë dhe fitimit të gradave, sipas përcaktimeve të ligjit nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, dhe vendimit nr. 895, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e ecurisë dhe fitimit të gradave, njësimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë, paraqitjen, formën dhe specifikimet teknike të gradave të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.

7. Akti i vlerësimit sipas pikës 6 të këtij udhëzimi, i dërgohet autoriteteve të përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të nenit 24 të ligjit nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.

8. Ngarkohet Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit të MZSH-së në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe bashkitë përkatëse, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Fatmir Xhafaj